



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE

VENDIM

Nr. 32 / 6, datë 30 / 10 / 2023

**PËR MOSPRANIM TË KËRKESËS PËR PËRFITIMIN E STATUSIT “INVESTIM/
INVESTITOR STRATEGJIK PROCEDURË E VEÇANTË”
PËR PROJEKTIN E INVESTIMIT “PARKU AGRIVOLTAIK FIER 170 MWP”,
ME SUBJEKT APLIKUES SHOQËRINË “FIER HELIOS SHPK” ME NUIS/NIPT
M22325031U**

Në mbështetje të neneve 9, 13, dhe 17 pika 5 të Ligjit Nr. 55/2015, “Për Investimet Strategjike në Republikën e Shqipërisë”, Kreu I, pika 3/a të VKM Nr. 1023, datë 16.12.2015 “Për Nënsektorët Strategjikë dhe Zonat me Përparësi Zhvillimi” dhe Kreut II, pika 8, 10 e VKM Nr. 1026, datë 16.12.2015 “Për vlerësimin e dokumentacionit të investimeve strategjike”, Komiteti i Investimeve Strategjike vlerësoi se:

- Projekti i investimit propozon zhvillimin, ndërtimin dhe funksionimin e një Parku Agri-Fotovoltaik 170 MWp, i vendosur në afërsi të fshatrave Fushë, Povelçë, Darëzë e re dhe Boçovë, Bashkia Fier.
- Vlera e investimit për projektin e propozuar parashikohet të jetë 150,000,000 (njëqind e pesëdhjetë milion) Euro.
- Pasuritë e paluajtshme që preken nga projekti i investimit të propozuar me një sipërfaqe prej 209.5 (dyqind e nëntë pikë pesë) ha, ndodhen në ZK Nr. 3038, Bashkia Fier.

Në përfundim, pasi u njoh me gjithë dokumentacionin e nevojshëm,

KOMITETI I INVESTIMEVE STRATEGJIKE
VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës për përfshirjen e projektit investues “Parku Agrivoltaik Fier 170 MWp”, në procedurën e veçantë dhe mbështetjen që ofron ky status.
2. Gjurma e synuar për këtë projekt investimi është e fragmentizuar, e destinacionit “arë” me bonitet të parcelave që fillon nga kategoria III deri tek kategoria X dhe bie

ndesh me parashikimet e Ligjit Nr. 9244, datë 17.6.2004 “Për mbrojtjen e tokës bujqësore”, i ndryshuar.

3. Projekti i propozuar është në mospërputhje me Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Fier.
4. Vendimi i Komitetit të Investimeve Strategjike publikohet dhe regjistrohet në Regjistrin e Investimeve Strategjike dhe i njoftohet kërkuarit nga Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve, në rolin e saj të Sekretariatit të Komitetit të Investimeve Strategjike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR I KOMITETIT TË INVESTIMEVE STRATEGJIKE

KRYEMINISTËR

EDI RAMA